



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2697/6 prot

Datë 14.10.2024

V E N D I M

Nr. 1437/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.10.2024 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-14199-07-24-2024, me objekt: “*Loti 1 “Blerje materiale te buta”* me fond limit 60 205 334 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.3, Tiranë

Ankimues: Operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK me NUIS K11409005S dhe me adresë: Autostrada Tirane-Durres, km 12.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlloritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.07.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-14199-07-24-2024, me objekt: “Loti 1 “Blerje materiale te buta” me fond limit 60 205 334 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 16.09.2024, operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK është njoftuar elektronikisht për vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave si vijon:

- | | |
|-----------------------------|-------------------------------|
| 1. “An&Ra” SHPK | 58.966.400 lekë, kualifikuar |
| 2. “Blerina Sadiku” PF | 59.440.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “Gjergji H Textile” SHPK | 54.032.000 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Arsyet e skualifikimit

“Operatori ekonomik GJERGJI H TEXTILE” sh.p.k me NUIS: K11409005S, referuar dokumentacionit ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk përmbush kërkesat e veçanta për kualifikim të përcaktuara në DT, për këto arsye: -Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.5 , Kriteret e Vecanta per Kualifikim në DST, ku është kërkuar shprehimisht: “2.3.5.Operatori ekonomik duhet te paraqese flete analizat/ raport testimet e lendes se pare per te gjithë artikujt sipas tabelës së shtojcës 6, leshuar jo me herët se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave, nga një laborator i akredituar, vendas ose i huaj” Referuar dokumenteve të paraqitura mbi testimet laboratorike nga GJERGJI H TEXTILE” sh.p.k, ofertuesi nuk vërtetoi se ato janë të lëshuara nga Institucione të Testimit të Akredituara në vendet përkatëse, dhe si të tilla nuk plotësojnë kërkesat e AK mbi vlefshmërinë ligjore të këtyre dokumenteve. Gjithashtu të gjitha testimet nuk shoqërohen me dokumente të lëshuara nga Institucione Qëndrore të Akreditimit të njohura nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Rrepublicën e Shqipërisë, referuar faqes zyrtare të DPA Shqipëri. Konkretisht mbi këtë kërkesë ofertuesi ka paraqitur këto dokumente: I. Raport testimi nga laboratorit Shaanxi Yalan Textile Kinë për artikullin “peshqir pambuku”. Në faqen e dytë të testimit ka një deklaram pa nënshkrim dhe pa vulë se testimi është i akredituar nga Bordi Qendror i Akreditimit në Kinë CNAS. KVO konstaton dhe gjykon se ky dokument nuk plotëson kërkesën për kualifikim pasi është thjesht një vetdeklaram i laboratorit për akreditim i pashoqëruar me vërtetimin e akreditimit nga autoriteti përkatës CNAS Kinë. II. Raport testimi nga laboratorit “Inertek Testing Services” Ltd Kinë, për artikullin “batanije” KVO konstaton dhe gjykon se ky dokument nuk plotëson kërkesën për kualifikim nuk është i shoqëruar e vërtetimin e akreditimit nga Bordi Qendror i Akreditimit në Kinë CNAS Kinë. III. Raport testimi nga laboratorit “SGS-CSTS CO” Kinë, për artikullin “dyshek”. KVO konstaton dhe gjykon se ky dokument nuk plotëson kërkesën për kualifikim nuk është i shoqëruar e vërtetimin e akreditimit nga Bordi Qendror i Akreditimit në Kinë CNAS Kinë. IV. Raport testimi nga laboratorit “Maqsood Ahmad Eëaving Factory” Pakistan, për artikujt “çarcaf dhe “jastëk”. Dokumenti 9 testimit shoqërohet me një certifikatë regjistrimi në dhomën e tregtisë Pakistan dhe dy certifikata ISO 9001 2008 dhe OEKO TEX te subjektit “Maqsood Ahmad Eëaving Factory”. KVO konstaton dhe gjykon se keto dokumente nuk plotësojnë kërkesën për kualifikim pasi certifikatat e cilësisë të laboratorit nuk përbëjnë aboslutisht dokumente mbi akreditimin e laboratorit dhe se keto testimet nuk janë shoqëruar me vërtetimin e akreditimit nga autoriteti përkatës Pakistan V. Ofertuesi ka paraqitur një sërë dokumentesh me titull Certifikata të Cilësisë të disa subjekteve prodhues textile Kinë të cilat nuk kanë lidhje me kërkesën për kualifikim sipas pikës 5 sesksioni 2.3 të Kerkesave te Vecanta për Kualifikim, pasi ato nuk janë as testimet laboratorike dhe as dokumentacion mbi akreditimin e testeve laboratorike. Konkretisht nuk kanë asnjë lidhje me dokumentacionin e kërkuara nga AK mbi testimet laboratorike dhe nuk janë tilla dokumentet e paraqitura më poshtë nga ofertuesi

Certifikata OEKO-TEX për subjektin “Hangzhou Songjia Eëaving” Ltd Kine -Certifikata ISO 9001 2018 për subjektin “FoShan Leizi Furniture” Ltd Kinë, - Certifikata ISO 9001 2018 për subjektin “Eëihai Hengtai Blanket” Ltd Kinë, - Certifikata ISO 14001 2015 për subjektin Rustam Toëel PVT Ltd Pakistan, -Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.6 , Kriteret e Vecanta per Kualifikim në DST, ku është

kërkuar shprehimisht: “2.3.6. Operatori ekonomik, ditën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të depozitohet pranë Operatorit të Blerjeve të Perqendruara, mallrat si mëposhtë vijon: Nr. Përshkrimi Njësia Sasia 1 Dyshekë sfungjeri antizjarr (një pjesë me permasa minimalisht 30x30 cm) Copë 1 2 Batanije teke Copë 1 3 Jastëk Copë 1 5 Këllëf jastëku Copë 1 4 Çarçaf tek Copë 1 6 Peshqir Copë 1 Për mallrat që kërkohet të jenë të loguara sipas shtojcës 5, duhet të paraqiten mostra të loguara. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për skualifikim Nga shqyrtimi i mostrave të paraqitura nga OE GJERGJI H TEXTILE” sh.p.k. me NUIS: K11409005S, rezulton se mostra e paraqitur për artikullin “Dyshekë sfungjeri antizjarr (një pjesë me permasa minimalisht 30x30 cm)” nuk përmbush specifikimet teknike pasi nuk është me veshje tekstili zjarrduruese të qepur me tegel dopio me thurje me fije zjarrduruese, si dhe nuk ka të qepur etiketën, e cila përmban, llojin e materialit, përmasat dhe të dhënat e tjera.”

II.3. Në datën 20.09.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4581, protokolluar me nr. 2697/2024 prot., datë 23.09.2024, e operatorit ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-14199-07-24-2024, me objekt: “Loti 1 “Blerje materiale te buta” me fond limit 60 205 334 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK.

II.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2697/2 date 24.09.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 2697 prot.

II.5. Në datën 24.09.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE.

II.6. Në datën 27.09.2024, në Komisionin e Prokurimit Publik është protokolluar me nr. 2697/3, shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 857/8 prot., datë 26.09.2024, me objekt: “Dërgim Vendimi”, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së me nr. 857/1 prot., datë 26.09.2024 “Mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK me NIPT K11409005S”. Referuar këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK, pasi është paraqitur përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit, në mënyrë që të fillonin afatet e ankimimit.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur

pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në datën 25.07.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-14199-07-24-2024, me objekt: “*Loti 1 “Blerje materiale te buta”* me fond limit 60 205 334 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

III.2. Në datën 16.09.2024, operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK është njoftuar elektronikisht për vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave si vijon:

- | | |
|-----------------------------|-------------------------------|
| 1. “An&Ra” SHPK | 58.966.400 lekë, kualifikuar |
| 2. “Blerina Sadiku” PF | 59.440.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “Gjergji H Textile” SHPK | 54.032.000 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Arsyet e skualifikimit

“Operatori ekonomik GJERGJI H TEXTILE” sh.p.k me NUIS: K11409005S, referuar dokumentacionit ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk përmbush kërkesat e veçanta për kualifikim të përcaktuara në DT, për këto arsye: -Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.5 , Kriteret e Vecanta per Kualifikim në DST, ku është kërkuar shprehimisht: “2.3.5.Operatori ekonomik duhet te paraqese flete analizat/ raport testimet e lendes se pare per te gjithë artikujt sipas tabelës se shtojcës 6, leshuar jo me herët se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave, nga një laborator i akredituar, vendas ose i huaj” Referuar dokumenteve të paraqitura mbi testimet laboratorike nga GJERGJI H TEXTILE” sh.p.k, ofertuesi nuk vërtetoi se ato janë të lëshuara nga Institucione të Testimit të Akredituara në vendet përkatëse, dhe si të tilla nuk plotësojnë kërkesat e AK mbi vlefshmërinë ligjore të këtyre dokumenteve. Gjithashtu të gjitha testimet nuk shoqërohen me dokumente të lëshuara nga Institucione Qëndrore të Akreditimit të njohura nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Rrepublicën e Shqipërisë, referuar faqes zyrtare të DPA Shqipri. Konkretisht mbi këtë kërkesë ofertuesi ka paraqitur këto dokumente: I. Raport testimi nga laboratorit Shaanxi Yalan Textile Kinë për artikullin “peshqir pambuku”. Në faqen e dytë të testimit ka një deklaram pa nënshkrim dhe pa vulë se testimi është i akredituar nga Bordi Qendror i Akreditimit në Kinë CNAS. KVO konstaton dhe gjykon se ky dokument nuk

plotëson kërken për kualifikim pasi është thjesht një vetdeklarim i laboratorit për akreditim i pashoqëruar me vërtetimin e akreditimit nga autoriteti përkatës CNAS Kinë. II. Raport testimi nga laboratorit “Inertek Testing Services” Ltd Kinë, për artikullin “batanije” KVO konstaton dhe gjykon se ky dokument nuk plotëson kërkesën për kualifikim nuk është i shoqëruar e vërtetimin e akreditimit nga Bordi Qendror i Akreditimit në Kinë CNAS Kinë. III. Raport testimi nga laboratorit “SGS-CSTS CO” Kinë, për artikullin “dyshek”. KVO konstaton dhe gjykon se ky dokument nuk plotëson kërkesën për kualifikim nuk është i shoqëruar e vërtetimin e akreditimit nga Bordi Qendror i Akreditimit në Kinë CNAS Kinë. IV. Raport testimi nga laboratorit “Maqsood Ahmad Eeaving Factory” Pakistan, për artikujt “çarçaf dhe “jastëk”. Dokumenti 9 testimit shoqërohet me një certifikatë regjistrimi në dhomën e tregtisë Pakistan dhe dy certifikata ISO 9001 2008 dhe OEKO TEX te subjektit “Maqsood Ahmad Eeaving Factory”. KVO konstaton dhe gjykon se keto dokumente nuk plotësojnë kërkesën për kualifikim pasi certifikatat e cilësisë të laboratorit nuk përbëjnë aboslutisht dokumente mbi akreditimin e laboratorit dhe se keto testime nuk janë shoqëruar me vërtetimin e akreditimit nga autoriteti përkatës Pakistan V. Ofertuesi ka paraqitur një sërë dokumentesh me titull Certifikata të Cilësisë të disa subjekteve prodhues textile Kinë të cilat nuk kanë lidhje me kërkesën për kualifikim sipas pikës 5 sesksioni 2.3 të Kerkesave te Vecanta për Kualifikim, pasi ato nuk janë as testime laboratorike dhe as dokumentacion mbi akreditimin e testimeve laboratorike. Konkretisht nuk kanë asnjë lidhje me dokumentacionin e kërkuara nga AK mbi testimet laboratorike dhe nuk janë tilla dokumentet e paraqitura më poshtë nga ofertuesi

Certifikata OEKO-TEX për subjektin “Hangzhou Songjia Eeaving” Ltd Kine -Certifikata ISO 9001 2018 për subjektin “FoShan Leizi Furniture” Ltd Kinë, - Certifikata ISO 9001 2018 për subjektin “Eeihai Hengtai Blanket” Ltd Kinë, - Certifikata ISO 14001 2015 për subjektin Rustam Toëel PVT Ltd Pakistan, -Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.6 , Kriteret e Vecanta per Kualifikim në DST, ku është kërkuar shprehimisht: “2.3.6. Operatori ekonomik, ditën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të depozitojë pranë Operatorit te Blerjeve te Perqendruara, mallrat si mëposhtë vijon: Nr. Përshkrimi Njësia Sasia 1 Dyshekë sfungjeri antizjarr (një pjesë me permasa minimalisht 30x30 cm) Copë 1 2 Batanije teke Copë 1 3 Jastëk Copë 1 5 Këllëf jastëku Copë 1 4 Çarçaf tek Copë 1 6 Peshqir Copë 1 Për mallrat që kërkohet të jenë të loguara sipas shtojcës 5, duhet të paraqiten mostra të loguara. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për skualifikim Nga shqyrtimi i mostrave të paraqitura nga OE GJERGJI H TEXTILE” sh.p.k. me NUIS: K11409005S, rezulton se mostra e paraqitur për artikullin “Dyshekë sfungjeri antizjarr (një pjesë me permasa minimalisht 30x30 cm)” nuk përmbush specifikimet teknike pasi nuk është me veshje tekstili zjarrduruese të qepur me tegel dopio me thurje me fije zjarrduruese, si dhe nuk ka të qepur etiketën, e cila përmban, llojin e materialit, përmasat dhe të dhënat e tjera.”

III.3. Në datën 20.09.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4581, protokolluar me nr. 2697/2024 prot., datë 23.09.2024 e operatorit ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të

Vlerësimet të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK.

III.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2697/2 date 24.09.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 2697 prot.

III.5. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit, në datën 24.09.2024.

III.6. Në datën 27.09.2024, në Komisionin e Prokurimit Publik është protokolluar me nr. 2697/3, shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 857/8 prot., datë 26.09.2024, me objekt: “Dërgim Vendimi”, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së me nr. 857/1 prot., datë 26.09.2024 “Mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK me NIPT K11409005S”. Referuar këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK, pasi është paraqitur përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit, në mënyrë që të fillonin afatet e ankimimit.

III.7. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.8. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës)”.

III.9. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.

Në rastin konkret, referuar verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar në SPE njoftimi i fituesit në datën 24.09.2024, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ndërkohë që nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ankesa e operatorit ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK është administruar me numër ankimi elektronik A/2024/4581, datë 20.09.2024 dhe protokolluar me nr. 2697/2024 prot., datë 23.09.2024.

III.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”,

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit (anulimit) dhe përfundon në ditën e 10-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik fillon në datën 24.09.2024 dhe përfundon në ditën e dhjetë. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e administruar në datën 20.09.2024, me nr. 2697 protokolli, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e tij nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-14199-07-24-2024, me objekt: “Loti 1 “Blerje materiale te buta” me fond limit

60 205 334 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Gjergji H Textile” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

